



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

**INFORMACION PËR VENDIMARRJEN DHE PERFORMACËN E KËSHILLIT TË
BASHKISË BERAT PËR VITIN 2021**

Të nderuar!

Këshilli i Bashkisë BERAT për vitin 2021 ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin rreth problematikave që janë shfaqur sidomos gjatë periudhës së PBA-së 2022-2024. Gjatë punës tonë jemi mbështetur te ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe legjislacioni sektorial për fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore si dhe në rregulloren e miratuar më datë 30.01.2020 me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr 5.

Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit 139/2015 ka rol vendimarrës, përfaqësues, mbikqyrës dhe monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role me angazhim dhe përkushtim. Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

a) *Roli vendimarrës*, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2021 janë realizuar në total 15 mbledhje të Këshillit

Në total janë miratuar 66 vendime .

Për shkak të masave kufizuese këtë vit janë zhvilluar 5 mbledhje on-line dhe 10 mbledhje me takime fizike në sallë. Ndërkohë 9 mbledhje janë transmetuar “online” nëpërmjet rrejetit social facebook dhe 6 nuk janë transmetuar “online”.

Këshilli i Bashkisë Berat ka përmirësuar ndjeshëm rolin e tij duke miratuar disa akte të cilat rregullojnë funksionet e tij edhe marrëdhëniet me komunitetin dhe administratën.

Konkretisht:

- Për herë të parë në Këshillin e Bashkisë Berat u miratua një “*Plan Aktivitetesh*” për 12 muajt e vitit 2021.
- Këshillin i Bashkisë Berat funksionoi duke zbatuar disa nga rregullat dhe standartet për ushtrimin e funksioneve të këtij organi duke u bazuar në ligjin 139/2015 dhe rregulloret që u kaluan me VKB, (*Rregullorja e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë, Rregullorja për Kodin e sjelljes dhe etikës së Këshillit të Bashkisë, Rregullorja e trajtimit të ankesave/kërkesave dhe iniciativave/peticioneve, Rregullorja e marrëdhënieve me komunitetin dhe mediat, Rregullorja e Strukturave komunitare*).

Këto rregullore përcaktojnë me detaje procedura dhe standarte për menyrën se si Këshilli ushtron të gjitha funksionet e tij. Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve Këshilli është asistuar nga Projekti “*Bashki të Forta*” i cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur implementimin e këtyre standarteve në mënyrë që të rritet roli i Këshillit të Bashkisë Berat.

- Rregullimi i faqes WEB duke azhornuar çdo aktivitet të Këshillit, sipas kërkesave të Rregulloreve (sipas modelit Bashkive të Forta).
- Duke vazhduar punën e nisur në vitin 2020 në Këshillin e Bashkisë Berat, në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i Ankesave/Kërkesave dhe një regjistër fizik i Nismave/Peticioneve ku regjistrohen, evidentohen dhe plotësohen *regjistrat* e Ankesave, Kërkesave, Vërejtjeve, Peticioneve, Nismave dhe Konsultimit Publik (në total janë 9 Kërkesa, 7 Konsultime Publike).

b) *Roli përfaqësues*, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Në lidhje me rolin përfaqësues në Këshillin e Bashkisë Berat për vitin 2021, është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht nëpërmjet publikimit, takimeve në komunitet dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet rrjeteve sociale, për të realizuar këtë qëllim është hapur adresa e Këshilli Bashkiak Berat në facebook.

Në këtë faqe janë të publikuara aktivitetet e Këshillit, Konsultimet me publikun, Rendi i ditës etj.

Për komunikim me qytetarët janë përdorur faqet facebook e Këshillit dhe WEB ku qytetarët kanë shprehur mendimet e tyre kryesisht për buxhetin 2022 në lidhje me prioritetet dhe mundësit

e financimit, kërkesat e tyre i janë bërë të ditur Drejtorisë së Financës me kërkesë nga Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit dhe disa janë përfshirë në buxhetin e vitit 2022.

c) *Roli mbikqyrës dhe monitorues*, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit të Bashkisë Berat, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruar nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve për vitin 2021 u realizuan dhe u paraqitën në Këshill informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vetë Këshilli.

Falenderojmë çdo person për kontributin dhe angazhimin, falenderojmë administratën e Bashkisë Berat për informacionet dhe bashkëpunimin, falenderojmë bashkëpunëtorët që asistojnë në aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Berat, projektin “*Bashki të Forta*” ku shpresojmë që ky bashkëpunim të vazhdojë me të gjithë dhe të përmirësohet akoma më shumë nëpërmjet vendimeve dhe sygjërimeve tuaja për të ndihmuar Këshillin e Bashkisë Berat që të funksionoj sa më mirë, afër qytetarëve, duke respektuar çdo ligj dhe duke zbatuar çdo rregullore

Punë të mbarë dhe faleminderit!